



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË  
INFRASTRUKTURËS DHE TERRITORIT

Nr.\_2188\_prot.

Tiranë, më\_11.03.2025

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim.

### **BASHKISË** \_\_\_\_\_

Në zbatim të ligjit 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, janë miratuar VKM Nr. 155, datë 11.03.2022 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”, dhe VKM Nr. 189, datë 30.03.2022 “Për përcaktimin e rregulloreve për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina”, te cilat kërkojnë angazhim te autoriteteve të njëjësive vendore në kuadër të zhvillimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike broadband. Gjithashtu bazuar në VKM Nr. 851 datë 07.12.2016 nga ana e bashkive kërkohet bashkëpunimi me AKEP për të dorëzuar të gjitha të dhënat dhe materialin e përditësuar hartografik mbi shtrirjen dhe kapacitetin e rrjeteve e të linjave infrastrukturore.

Bazuar në udhëzimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr. 10 datë 23.12.2024, është ndërmarrë një analizë e zbatimit të ligjit 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nga një verifikim i informacionit të publikuar në faqen e internetit të bashkisë tuaj, na rezulton se nuk ka informacion në lidhje me sa kërkohet në VKM Nr. 155, datë 11.03.2022 ose në VKM Nr. 189, datë 30.03.2022 në vecanti lidhur me rregullat, procedurave për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.


Sa më sipër kërkojmë bashkëpunimin tuaj për dërgimin e një informacioni mbi rregullat, procedurat, tarifatat e aplikuara nga ana e bashkisë tuaj, në lidhje me ndërtimin e rrjeteve të komunikimit elektronike të shpejtësisë së lartë/broadband si dhe mundësimin e publikimit apo përditësimin e informacionit në faqen tuaj të internetit si më poshtë:

- Rregullat dhe procedurat për dhënien e lejeve për të drejtën e kalimit, të parashikuara në VKM Nr. 155 datë 11.03.2022.
- Rregullat dhe procedurat e miratuara në zbatim të ligjit për zhvillimin e territorit dhe VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"
- Publikimi në atlasin e broadband të AKEP të rrjetit të infrastrukturës passive të ndërtuar nga bashkia sipas parashikimeve në VKM Nr. 851 datë 07.12.2016.
- Publikimi i informacionit mbi inspektimet që kryen bashkia për pikat e aksesit në infrastrukturë në godinat e reja dhe egzistuese në zbatim të VKM Nr. 155, datë 11.03.2022
- Caktimi i pikës së kontaktit për lehtësimin e procesit së dhënies së lejeve, për të drejtën e kalimit, për ndërtimin e rrjeteve të komunikimit me shpejtësi të lartë.

Gjithashtu vlerësojmë rritjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit me AKEP në lidhje me kryerjen e punimeve mbi infrastrukturën për zbatimin e parimit "Gërmo një herë" të parashikuar në ligjin nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit"

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, për çdo sqarim apo informacion shtesë lutem kontaktoni në adresën: [altin.sallaku@infrastruktura.gov.al](mailto:altin.sallaku@infrastruktura.gov.al).

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**



**Viola Haxhiademi**